



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KONISPOL

Konispol më 17.04.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot më datë 04.03.2024 në Konispol , nga ana e Njesisë së Prokurimit me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “**E Hapur**”, dhe në referim të urdhërit të prokurimit nr. 1 Datë 01.03.2024, me të dhënat si vijon:

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër

BLERJE MATERIALE NDERTIMI

- Fondi limit **25 019 357** (*Njëzetë e pesë milionë e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë*) **Lekë , pa TVSH**

(Financimi në 2 vite, 50% në vitin 2024 dhe 50% në 2025)

- Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2024

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia KONISPOL**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojcë

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore në një vlerë jo më të ulët se fondi limit për të paktën njërin nga vitet 2022 ose 2023.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit

duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet e sipër përmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar ne nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik: b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, te certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2022 dhe 2023 ku raporti ndërmjet aktivitet dhe pasivitet muk është negativ.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Furnizime të ngjashme në një vlerë prej (40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

1. Kontrata të ngjashme për furnizime me entitete që ka realizuar këtë lloj furnizimi e shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura/tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”... *vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit të mallrave objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 4 (katër) persona .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Listpagesat sipas formularit të standartit për sigurimet
- Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar.

2.3.3 Operatorët Ekonomik duhet të kenë të punësuar 3 (tre) drejtues automjetesh dhe 1 (nje) drejtues mjete per kamion vetshkarues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punojesve te siperpermendur.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, te gjithe dokumentacionin provues si me poshte:

- kontratë pune të vlefshme
- dëshminë e drejtimit të automjetit e vlefshme
- si dhe të figurojnë në list-pagesat e sigurimeve shoqerore.

Në rastin kur makineritë disponohen me qera, për drejtuesit e mjeteve nuk do te kërkohen list-pagesat e Sigurimeve Shoqerore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Cope 1
	Kamion vetshkarkues (kapaciteti jo më pak se 15 ton)	në pronësi ose me qira	Cope 1
2	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo më pak se 6 ton)	në pronësi ose me qira	Cope 1
3	Autobetonjere me kapacitet transportues 5-12 m3	në pronësi ose me qira	Cope 1
4	Fabrikë për prodhimin e asfaltobetoneve, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje Mjedisore Kodi III.1B, Aktin e miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit) e vendosur jo më larg se 50 km nga qendra Konispol.	në pronësi / me qira / kontrate furnizimi	Cope 1

5	Fabrikë për prodhimin e betonit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje Mjedisore Kodi III.1B, certifikate cilesie ISO 9001- 2015 (e vlefshme) e vendosur jo më larg se 50 km nga qendra Konispol.	në pronësi / me qira / kontrate furnizimi	Cope 1
---	---	---	--------

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK,perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme*

b) per mjetet me qera,

- 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, I cili duhet te jete deri ne perfundim te kontrates.*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 2. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Pavarësisht se kemi të bëjmë me një kontratë mallrash, lidhur me natyrën specifike të mallrave që kërkohen (beton, asfalt), operatori ofertues duhet të zotërojë makineritë e kërkuara për ti prodhuar dhe transportuar këto mallra.

Mjetet janë kërkuar bazuar në sasisë e punimeve sipas preventivit.

2.3.5 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Certifikat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015;

Argumentimi: Në zbatim të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- **Argumentimi i specifikimeve teknike**

- **Beton** Beton C-20/25 (Me cakell)
- Inertet (të imta dhe të trasha) për të gjitha tipet e betonit duhet të përdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose në përputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale”. Ato duhet të jenë të fortë dhe të qëndrueshem dhe nuk duhet të përmbajnë materiale të dëmshme që veprojnë kundër fortësisë ose qëndrueshmërisë së betonit ose, në rast të betonarmese mund të shkatërrojë këtë përforsim.

Klasa e betonit	Max. i ujit të lirë/raporti cemento
Klasa A&A (M100) (s)1:1,5:3	0.5
Klasa B&B (M200) (s)1:2:4	0.6
<u>Klasa C&C (M250) (s)1:3:6</u>	<u>0.65</u>

Shënim. (s) = Çimento sulfatë e rezistueshme.

- **Asfaltobeton me granil guri kave**

➤ Asfaltobetoni për ndërtimin e shtresave rrugore përgatitet nga përzierja në të nxehtë e materialeve mbushës (çakëll, granil, rërë e pluhur mineral) me lëndë lidhëse bitum.

- Asfaltobeton i ngjeshur, i cili përgatitet me çakëll të thyer e granil në masë 35 deri 40%, rërë 50% dhe pluhur mineral 5 deri 15% dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës në masën 3 deri në 5% në volum.

Kërkesat teknike që duhet të plotësojë asfaltobetoni sipas STASH 660-87

Nr.	Treguesit teknik	Asfalto beton I ngjeshur		Asfaltobeton poroz (binder)
		Kategoria I	Kategoria II	
1	Rezistenca në shtypje në temp. $20 \square \square C/cm^2$ jo më pak se	25		
2	Rezistenca në shtypje në temp. $50 \square \square C/cm^2$ jo më pak se	10		
3	Qëndrueshmëria ndaj të nxehtit $K_{nx} = R-20/R50$	2.5		
4	Qëndrueshmëria ndaj ujit K-ujë jo më pak se	09		
5	Poroziteti përfundimtar (mbas ngjeshjes) në % në vëllim	3-5		
6	Ujëthithja % në vëllim jo më shumë se	1-3	1-5	7-10
7	Mufatja % në vëllim jo më shumë se	0.5	1	2

• **Afati i lëvrimit**

Afati për furnizimin me mallrat e kërkuar do të jetë nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2024 dhe lëvrimi do të bëhet sipas nevojave të bashkisë duke rakorduar të dyja palët paraprakisht.